

**Njoftim i përqendrimit me të cilin Dojçe Lufthanza Akciengesellschaft nga Gjermania do të fitojë kontroll të pavarur mbi ItaliaTrasporto Aereo S.p.A.**

**(lënda nr. 08-149/ 2023)**

Në përputhje të nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më 10.10.2023, te Komisioni për mbrojtjen e konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim që i referohet fitimit të kontrollit të pavarur nga Dojçe Lufthanza Akciengesellschaft me seli në Fenloer Shtrase 151-153, 50672 Kelln, Gjermani mbi ItaliaTrasporto Aereo S.p.A. me seli në Via Venti Settembre, 97, Rome - Itali.

- **Dojçe Lufthanza Akciengesellschaft** është një shoqëri Holding e Grupit Lufthanza, një shoqëri aviacioni nga Gjermania me operacione biznesi në mbarë botën, me seli në Kelln, Gjermani. Dojçe Lufthanza Akciengesellschaft ofron shërbime për transport ajror pasagjerësh, transport ajror mallrash dhe shërbime të ngjashme. Ajo kryen fluturime në 320 destinacione në 104 vende, me një flotë prej më shumë se 700 avionësh. Qendrat kryesore të DLH për biznesin ndërkombëtar janë Frankfurt, Munihi, Cyrihu, Brukseli dhe Vjena. Me 109,509 punonjës, Grupi Lufthanza transportoi rreth 101.8 milionë pasagjerë. Grupi Lufthanza operon fluturime nga/për Maqedoninë e Veriut dhe Austrian Airlines ka një filial në Shkup - Austrian Airlines AG Vjenë - Austria Ofis Park 2 1300 Vienna Airport Austria Filiali i Austrian Airlines AD - Mralino Ilinden (me zyrë të regjistruar në BOSFOR nr. 1, Aeroporti Ndërkombëtar - Shkup / Zyra 2087-8 Mralino, Ilinden) dhe aktiviteti prioritar i regjistruar 51.10 - Transporti ajror i udhëtarëve).

- **Italia Trasporto Aereo S.p.A.** e cila në operacionet e saj tregtare vepron si Italia Trasporto Aereo S.p.A. është një linjë ajrore kombëtare e Italisë, me seli në Romë. ITA është themeluar më 9 tetor 2022 sipas ligjit italian dhe është nën kontrollin e MEF-it italian. Që nga 15 tetori 2021, ITA është kryesisht aktive në fushën e shërbimeve të transportit ajror të pasagjerëve në fluturimet e brendshme dhe ndërkombëtare. ITA nuk ka një shoqëri të varur të regjistruar dhe nuk kryen fluturime nga/për Maqedoninë e Veriut.

Tregu relevant i mallrave për përqendrimin e paraqitur mund të përkufizohet si treg për ofrimin e shërbimeve të transportit ajror të pasagjerëve sipas orarit.

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

10.10.2023

Shkup